BROSHURË MBI TREGUESIT SHËNDETËSOR PËR IDENTIFIKIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT DHE VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

MARRI
Migration, Asylum, Refugees Regional Initiative

Terre des hommes
Aide à l'enfance.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....2
TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE.....3
PERSONAT E CENUESHËM NDAJ TRAFIKIMIT
TË QENIEVE NJERËZORE.....3
PARIMET UDHËZUESE GJATË PUNËS ME VIKTIMAT
E TRAFIKIMIT.....4
PASOJAT SHËNDETËSORE TË TRAFIKIMIT TË
QENIEVE NJERËZORE.....5
HAPAT QË DUHET TË NDËRMERREN KUR DYSHOHET SE
DIKUSH ËSHTË VIKTIMË E TRAFIKIMIT.....6
TREGUESIT SHËNDETËSOR PËR IDENTIFIKIMIN E VIKTIMAVE
TË TRAFIKIMIT DHE VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË
TRAFIKIMIT.....8

HYRJE

Trafikimi i qenieve njerëzore përkufizohet si një rrezik shumë serioz për shëndetin sepse lidhet me lëndimet fizike dhe dëmet psikologjike që pësojnë viktimat e tij.

Krizat ndikojnë te trafikimi i qenieve njerëzore edhe në rajone që strehojnë migrantët si vende transiti apo destinacioni.

Qëllimi i dokumentit

Ky dokument synon të ofrojë udhëzime praktike dhe joklinike për të ndihmuar ofruesit e kujdesit shëndetësor të prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë lidhur me identifikimin e viktimave të trafikimit (në vijim VT-të) dhe viktimave të mundshme të trafikimit (në vijim VMT-të):

- Të njohë problemet shëndetësore që lidhen me trafikimin dhe për të marrë parasysh qasje të sigurta dhe të përshtatshme për ofrimin e kujdesit shëndetësor për personat e trafikuar.
- Të përshkruajë rolin e ofruesit të kujdesit shëndetësor në identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

Audienca e synuar

- Mjekët e përgjithshëm, specialistët dhe punonjësit e tjerë të kujdesit shëndetësor (gjinekologë, neurologë, specialistë të sëmundjeve infektive, pediatër, dentistë, psikologë ose psikiatër dhe të tjerë);
- Stafi i urgjencës;
- Ofruesit privat dhe publik të kujdesit shëndetësor;
- Klinika të lëvizshme;
- Çdo profesionist tjetër i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në identifikimin e viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

(a) “Trafikimi i personave” nënkupton rekrutimin, transportin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave përmes kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga situata e cenueshme, ose duke dhënë ose marrë pagesa ose përfitime për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e tij/saj. Shfrytëzimi përfshin, të paktën, shfrytëzimin për qëllime prostitucioni të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, shfrytëzimin për qëllime pune ose shërbime të detyruara, shfrytëzimin për qëllime skllavërimi ose forma të ngjashme me skllavërimin, shfrytëzimin për qëllime të dhënies ose transplantimit të organeve;

(b) Miratimi i viktimës së trafikimit të personave për shfrytëzimin e synuar të parashikuar në nënparagrafin (a) të këtij neni nuk do të jetë me rëndësi nëse është përdorur ndonjë nga mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a);

(c) Rekrutimi, transporti, transferimi, fshehja, ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin do të konsiderohet “trafikim i personave” edhe nëse kjo gjë nuk përfshin asnjë nga mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a) të këtij neni.

PERSONAT E CENUESHËM NDAJ TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

- Të mitur të pashoqëruar dhe të ndarë nga prindërit, të mitur në lëvizje/ të mitur migrantë dhe refugjatë;
- Të mitur viktima të dhunës, neglizhencës dhe keqtrajtimit;
- Familje me kryefamiljare gra (migrante), gra dhe vajza viktima të dhunës në familje;

- Emigrantët dhe refugjatët;
- Viktimat e identifikuara ose të paidentifikuara tashmë të trafikuara të përfshira në një krizë;
- Njerëzit që i përkasin grupeve minoritare dhe viktimat e diskriminimit etnik, racor, fetar, social etj.;
- Popullsia e zhvendosur që shkon drejt migrimit të pasigurt;
- Personat e cenueshëm për shkak të gjinisë dhe seksit, moshës, orientimit seksual, statusit të parregullt social, ekonomik, politik e kështu me radhë;
- Personat me aftësi të kufizuara.

PARIMET UDHËZUESE GJATË PUNËS ME VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

Parimet e mëposhtme udhëzuese përfaqësojnë standarde të përgjithshme etike gjatë punës me viktimat e trafikimit:

- Mos i lëndoni;
- Mos i diskriminoni;
- Mësoni më shumë për pacientin tuaj dhe vlerësoni rreziqet;
- Përgatitni të dhënat e referimit, mos bëni premtime që nuk mund t'i mbani;
- Zgjidhni dhe përgatitni përkthyesit dhe bashkëpunëtorët në mënyrë të përshtatshme;
- Garantoni ruajtjen e anonimitetit dhe konfidencialitetit;
- Merrni pëlqimin e informuar;
- Dëgjoni dhe respektoni vlerësimin e çdopersoni për situatën dhe rreziqet që cenojnë sigurinë e tyre;
- Mos i ritraumatizoni individët;
- Përgatituni për ndërhyrje emergjente;
- Përdorni informacionin e mbledhur në mënyrë efektive.

PASOJAT SHËNDETËSORE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Ndikimet në shëndet dhe mirëqenie në faza të ndryshme të trafikimit të qenieve njerëzore:

REKRUTIMI
Histori abuzimesh apo privimi nga nevojat bazë
Ndikimi socio-ekonomik
Sjellja shëndetësore

UDHËTIMI DHE TRANZITI
Transporti me rrezik të lartë
Fillimi i ushtrimit të dhunës
Konfiskimi i dokumenteve

IZOLIMI
Privimi, kushte johigjienike
Kushte stresuese
Shërbimi i dobët shëndetësor

SHFRYTËZIMI
Kushte të këqija pune
Dhunë fizike, seksuale dhe psikologjike
Lëvizje e kufizuar

RITRAFIKIMI
Cenueshmëri e veçantë lidhur me shfrytëzimin e mëparshëm

INTEGRIMI
Përshtatja kulturore
Turpi, stigma
Shërbime të kufizuara

RI-INTEGRIMI
Ripërshtatja shoqërore
Turpi, stigma
Ndëshkimi i trafikantëve



HAPAT QË DUHET TË NDËRMERREN NË RAST DYSHIMI PËR VIKTIMË TË TRAFIKIMIT

Krijoni një marrëdhënie me pacientin

↓

Kërkoni të dhëna dhe dalloni treguesit e alarmit

↓

Garantoni sigurinë e pacientit tuaj

↓

Ofroni përkujdesje urgjente nëse është e nevojshme

↓

Bisedoni me pacientin tuaj (përdorni “mjetin e vlerësimit”)

↓

Dokumentoni çdo vetëidentifikim të kryer nga viktima dhe çdo gjetje nga vlerësimi juaj shëndetësor që dëshmon se mund të kemi të bëjmë me shfrytëzim lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

Pas vlerësimit fillestar:

1. Nëse dyshoni se pacienti juaj është viktimë e trafikimit, raportoni çështjen në polici. Nëse personi në fjalë është fëmijë, raportoni çështjen edhe në Qendrën kompetente për Punë Sociale.
2. Nëse dyshoni se pacienti juaj është në një situatë që mund të çojë në trafikim të qenieve njerëzore, referojeni/raportojeni çështjen/pacientin në Polici dhe në Qendrën për Punë Sociale dhe gjithashtu informoni personin për çdo Strehëz të sigurt dhe/ose OJQ që punon për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe jepini informacion lidhur me shërbimet e disponueshme, duke përfshirë linjat telefonike.

Diagrami i lëvizjeve për hapat që duhen ndërmarrë nëse dyshohet se kemi të bëjmë me një VT të rritur:



TREGUESIT SHËNDETËSOR PËR IDENTIFIKIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT DHE VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT

→ TREGUESIT E PËRGJITHSHËM SHËNDETËSOR

TREGUESIT FIZIK

- Kequshqyerje ose shëndet i dobët në përgjithësi: probleme me të ushqyerit (kequshqyerje, humbje akute e peshës, humbje e oreksit)
- Persona të tjerë që flasin në emër të personit
- Shenja të dhunës fizike, në veçanti:
  - Mavijosje
  - Sy të nxirë
  - Djegie
  - Prerje
  - Kocka të thyera
  - Dhëmbë të thyer
  - Shenja të shumta (përfshirë shenjat nga shoku elektrik)
- Dëshmi e një infeksioni të zgjatur që mund të trajtohej lehtësisht përmes një kontrolli rutinë fizik
- Varësi nga droga dhe/ose alkooli
- Sëmundje neurologjike: dhimbje koke, migrenë, lodhje, humbje e kujtesës, merrje mendsh pa një shkak të njohur, pagjumësi
- Sëmundje kardiovaskulare/respiratore që shkaktohen nga stresi: presioni i lartë i gjakut, aritmia, destresi respirator akut
- Sëmundje gastrointestinale që shkaktohen nga stresi (kapsllëk, sindroma e zorrës së irrituar)
- Shfaqja e lodhjes ekstreme (rrathë të zinj poshtë syve ose sy të fryrë, lëvizje të ngadalta të trupit), çehre gri
- Sëmundjet infektive (tuberkulozi, parazitët e zorrëve, hepatiti)
- Sëmundje kronike e pazbuluar ose e patrajtuar (diabeti, hipertensioni)
- Impetigo dhe infeksione mykotike

TREGUESIT PSIKOLOGJIK

- Lidhja me trafikantin ose viktimat e tjera për shkak të traumës (p.sh. sindroma e Stokholmit)
- Makthe, kujtime traumatike
- Ideja për të kryer vetëvrasje
- Shtimi i sjelljeve me rrezik të lartë, si për shembull arratisja ose aktiviteti i hershëm seksual nëse është i mitur
- Fobitë
- Vetëgjymtimi
- Çrregullimet e të ushqyerit
- Abuzimi me substancat toksike dhe alkoolin
- Çrregullime nga stresi post-traumatik:
  - Simptoma të vazhdueshme të zgjimit të shpeshtë (vështirësi për të rënë apo për të fjetur gjumë, nervozizëm, shpërthime zemërimi, vështirësi në përqendrim, trembje e ekzagjeruar)
  - Stres/reaktivitet intensiv pas një fenomeni që simbolizon ose i ngjan ngjarjes traumatike
- Hipervigjilencë ose paranojë, frikë, depresion, nënshtrim, tension dhe/ose nervozizëm
- Çrregullime të lidhjes emocionale:
  - Mungesë e ndërveprimeve sociale ose vështirësi për t'u përfshirë në to
- Shenja tërheqjeje në vetvete, frike, trishtimi ose nervozizmi
- Depersonalizimi ose derealizimi:
  - Ndihen sikur e vëzhgojnë veten nga jashtë, sikur e shohin veten në një film
  - Mpirje emocionale ose fizike e shqisave
  - Ndihen të tjetërsuar ose sikur nuk e njohin mjedisin përreth
- Çrregullimet disociative:
  - Humbje kujtese
  - Ndjenja e të qenit i shkëputur nga vetja
  - Mungesë e ndjenjës së vetë-identitetit ose kalimi në identitete alternative

TREGUESIT E SJELLJES

- Raportime për dhunë në familje, dhunë fizike, emocionale dhe/ose seksuale – ose neglizhencë
- Zhvillim i vonuar fizik ose kognitiv
- Vështirësi në krijimin ose mbajtjen e marrëdhënieve të shëndetshme
- Nuk është në gjendje të japë adresën aktuale
- Tjetërsim
- Ngurrim për të pranuar ndihmë
- Është trajtuar në disa spitale të ndryshme, por nuk duket se është ndjekur në mënyrë të përshtatshme
- Historiku mjekësor nuk përkon me lëndimet
- Nuk ka sigurim shëndetësor

→ TREGUESIT SPECIFIKË SHËNDETËSORË SIPAS LLOJIT TË SHFRYTËZIMIT

SHFRYTËZIMI SEKSUAL

- Është verifikuar se personi është nën 18 vjeç dhe se është i përfshirë në industrinë e seksit
- Mospërputhje ndërmjet sjelljes dhe moshës së raportuar, d.m.th. të dhëna në sjellje ose pamje që sugjerojnë se personi është i mitur, por ai/ajo gënjen për këtë gjë
- Dëshmi të traumës seksuale
- Infeksione të shumta ose të shpeshta seksualisht të transmetueshme (IST), veçanërisht prova për mungesën e trajtimit për IST-të
- Infeksion i patrajtuar i traktit urinar
- Inkontinenca
- Dëmtimet rektale
- Shtatzëni të shumta ose të shpeshta (pesha e ulët e nënës, përdorimi i drogave të paligjshme gjatë shtatzënisë, moskryerja e kontrolleve të rregullta shëndetësore të nënës)
- Personat nën moshën 18 vjeç që shprehin interes ose mund të jenë

tashmë në marrëdhënie me të rritur ose burra të moshuar
- Personi është i veshur me veshje të papërshtatshme (p.sh., të brendshme apo veshje të tjera të lidhura me industrinë e seksit)
- Prania e shenjave të pashpjegueshme ose të pazakonta – me shumë mundësi nga abortet e detyruara
- Tatuazhe në qafë dhe/ose në pjesën e poshtme të shpinës që personi ngurron t'i shpjegojë p.sh. emri ose inicialet e një burri
- Lloje të tjera shenjash p.sh. prerja ose djegia
- Prova se viktimës i është dashur të kryejë marrëdhënie seksuale gjatë ciklit menstrual p.sh. përdorimi i tamponëve ose produkteve të tjera që lënë pas mbetje
- Viktimat e shfrytëzimit seksual shpesh goditen në pjesë të trupit që nuk dëmtojnë pamjen e tyre, si p.sh. në pjesën fundore të shpinës
- Çdo traumë faringale (çarje, shqyerje)

SHFRYTËZIMI PËR PUNË

- Pasojat shëndetësore të ekspozimit të gjatë ndaj temperaturave ekstreme ose disa përbërësve kimikë (në bujqësi, industri)
- Gjendja e lëkurës për shkak të mungesës së higjienës ose përdorimit të produkteve të rrezikshme
- Dhimbje shpine, probleme shqisore (shikimi, dëgjimi) dhe probleme me frymëmarrjen
- Pengimi i rritjes dhe/ose mungesë zhvillimi kognitiv
- Cenueshmëri për shkak të një paaftësie ose gjendje tjetër cenueshmërie psikologjike ose fizike (p.sh. shtatzënia)/dëmtime fizike që duket se vijnë si rezultat i gjymtimit me qëllim lypjen

TRAFIKIMI I ORGANEVE

- Shenja kirurgjikale
- Keqpërdorimi i materialeve riprodhuese
- Përveç heqjes së organit "të dakordësuar", heqja e organeve jetësore (që nuk duhet të ishin hequr)

→ TREGUESIT PËR DHUNË FIZIKE NDAJ FËMIJËVE

TREGUESIT FIZIK TË ABUZIMIT FIZIK

- Lëndime të pashpjegueshme
- Djegiet (veçanërisht nga cigaret)
- Shpjegime të pabesueshme ose jokontradiktore për lëndimet
- Mavijosje të shumta në faza të ndryshme shërimi
- Mavijosje në fytyrë, veshë, qafë, fundshpinë, shpinë, gjoks, kofshë, shputat e këmbëve dhe organet gjenitale
- Mavijosje që ngjajnë me objekte të tilla si dora, grushti, tokëz rripi
- Lëndimet që janë të çuditshme për moshën/nivelin e zhvillimit të fëmijës

TREGUESIT E SJELLJES LIDHUR ME ABUZIMIN FIZIK

- Ka frikë të kthehet në shtëpi dhe ka frikë nga prindi ose kujdestari
- Shqetësim ose vigjilencë ekstreme
- Agresivitet ose pasivitet i theksuar
- Trembet lehtë ose shmang kontaktin fizik
- Sjellje apo fjalë abuzive gjatë lojës
- Nuk kujton dot si është lënduar
- Shkaku i lëndimeve nuk përkon me natyrën e lëndimeve

→ TREGUESIT E ABUZIMIT OSE SHFRYTËZIMIT SEKSUAL

TREGUESIT FIZIK TË ABUZIMIT OSE SHFRYTËZIMIT SEKSUAL

- Çrregullimet e gjumit
- Urinimi në gjumë
- Dhimbje ose acarim në zonën gjenitale/anale
- Vështirësi në ecje ose gjatë qëndrimit ulur
- Vështirësi në urinim
- Shtatzëni
- Testi pozitiv për sëmundje seksualisht të transmetueshme ose HIV

TREGUESIT E SJELLJES LIDHUR ME ABUZIMIN OSE SHFRYTËZIMIN SEKSUAL

- Shthurje seksuale
- Kryerja e lojërave dhe/ose vizatimeve seksuale jo të përshtatshme për moshën
- Sjellje mizore ndaj të tjerëve
- Sjellje mizore ndaj kafshëve
- Zjarrvënie
- Ndjenjë ankthi
- Mbyllja në vetvete

→ TREGUESIT E DËMEVE TË RËNDA MENDORE

TREGUESIT FIZIK TË DËMEVE TË RËNDA MENDORE Y

- Ankesa të shpeshta psikosomatike (p.sh., të përziera)
- Urinim në gjumë
- Vetëlëndim
- Çrregullime në të folur

TREGUESIT E SJELLJES LIDHUR ME DËMET E RËNDA MENDORE

- Shprehje e vetëbesimit të ulët
- Frikë për të provuar gjëra të reja
- Respekton rregullat më shumë se zakonisht
- Marrëdhënie të ftohta me bashkëmoshatarët
- Varësi e tepërt nga të rriturve
- Çrregullime të zakoneve (thith gishtin, lëkund trupin, etj.)
- Çrregullime të të ushqyerit

→ TREGUESIT E NEGLIZHIMIT TË RËNDË FIZIK

TREGUESIT FIZIK LIDHUR ME NEGLIZHIMIN E RËNDË FIZIK

- Mungesë e kujdesit të duhur mjekësor dhe dentar
- Shpesh i uritur/Pa strehë
- Pesha e fëmijës është dukshëm më e ulët se mesatarja normale për moshën dhe gjininë e tij/saj
- Zhvillim i vonuar
- Kushte të vazhdueshme (të patrajtuara) (p.sh., morra, skuqje nga pelenat)
- Veshje të papastra, të papërshtatshme për motin, shumë të vogla/ të mëdha
- Ekspozimi ndaj rreziqeve

TREGUESIT E SJELLJES LIDHUR ME NEGLIZHIMIN E RËNDË FIZIK

- Nuk është i regjistruar në shkollë
- Mbikëqyrje e papërshtatshme ose e pavend
- Lodhet shpesh
- Sjellje prindërore (kur fëmijët detyrohen të ndërmarrin rolin dhe përgjegjësitë e prindit)

Ky publikim mbështetet nga Projekti Rajonal për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore financuar nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe zbatuar nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) së bashku me partnerin strategjik Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI).

Analizat, rezultatet dhe rekomandimet në këtë publikim përfaqësojnë opinionin e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) apo të Iniciativës Rajonale per Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI).

Publikuar nga:
Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Selia:
Bonn dhe Eschborn, Gjermani

Projekti Rajonal mbi:
Parandalimi dhe Lufta Kundër Trafikimit të
Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor
Martin Hiebsch
Antonie Grubisikj 5
1000 Shkup, Maqedonia e Veriut
T +389 23103560
E martin.hiebsch@giz.de
I www.giz.de/en

Autori:
Bistra Netkova

Modeli:
Brand Union DOO Shkup

Në emër të:
Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim
Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)

Më datë:
Shtator 2022